



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 1.11.2021 ora 11:30

#### Drejton mbledhjen:

**Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 19.10.2021 dhe 21.10.2021.
2. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit (për periudhën 25 tetor- 12 nëntor 2021).
3. Miratimi i kalendarit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”.
4. Shqyrtimi i aktit normativ nr. 30, datë 27.9.2021 “Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet PFIZER EXPORT B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave”” (*Komision përgjegjës*).

#### **Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Saimir Hasalla, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Oerd Bylykbashi, Gazmend Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Elda Hoti, Erisa Xhixho, Gerta Duraku, Toni Gogu, Gledis Çeliku, Bledion Nallbati dhe Fatmir Xhafaj.

#### **Mungojnë:**

Damian Gjikhuri, Jurgis Çyrbja, Ermonela Valikaj (Felaj) dhe Dhurata Çupi (Tyli).

#### **Të ftuara:**

Eugena Tomini – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrrena – Drejtoreshë Juridike e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

## HAPET MBLEDHJA

**Klotilda Bushka – Mirëdita!**

Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të datës 1 nëntor 2021 me rend dite si vijon: miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 19.10.2021 dhe 21.10.2021, miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit (për periudhën 25 tetor-12 nëntor 2021), miratimi i kalendarit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, dhe pika e katërt e rendit të ditës është shqyrtimi i aktit normativ nr. 30, datë 27.9.2021 “Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet PFIZER EXPORT B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave”, për të cilin jemi komision përgjegjës dhe relator do të jetë zoti Toni Gogu.

Para se të fillojmë me çështjet e rendit të ditës për sa i takon miratimit të procesverbaleve të mbledhjeve të datave 19.10.2021 dhe 21.10.2021, më duhet t’ju them se në kalendarët që janë shpërndarë mungojnë dy të dhëna.

E dhëna e parë ka të bëjë me projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin “Për birësimet”” dhe “Për disa ndryshime në Kodin e Familjes”, për të cilët, përveç relatores, zonjës Mara, do të jetë edhe një relator nga opozita, që do të jetë zonja Greta Bardeli. Ndërsa për projektligjin e mbikëqyrjes policore, përveç relatores zonjës Felaj, do të ketë një relator edhe nga opozita, që do të jetë zoti Sula.

Fillojmë me miratimin e çështjeve të rendit të ditës.

Jeni dakord me procesverbalet e mbledhjeve të kaluara?

Dakord. Miratohen procesverbalet e mbledhjeve të datave 19.10.2021 dhe 21.10.2021.

Vazhdojmë me miratimin e kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 25 tetor-12 nëntor 2021, me ndryshimet që ju prezantova.

Jemi dakord të gjithë? Dakord.

Vazhdojmë me miratimin e kalendarit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”. Jemi dakord të gjithë? Dakord.

Atëherë, relatorë do të jenë zoti Alqi Bllako...

Nuk i kemi të shënuar relatorët në kalendar? Sekretaria, janë? Atëherë, unë kam një version pa emra. Dakord, atëherë, edhe me kalendarët, sipas përmbajtjes përkatëse që u është shpërndarë të gjithë anëtarëve.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës. Kemi ftuar dhe janë paraqitur në komision zonjat Eugena Tomini, zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mirë se erdhët, zonja Tomini, e shoqëruar nga zonja Antoneta Njehrrëna, drejtoreshë Juridike po nga kjo ministri.

Zonja Tomini, ne do të donim një parashtrim nga ana juaj të aktit për të cilin jemi mbledhur për shqyrtim sot.

Thjesht vë në dijeni anëtarët e komisionit se bëhet fjalë tashmë për të njëjtin akt që e kemi miratuar në mbledhjen e mëparshme të komisionit për sa i takon tekstit të ndryshuar të marrëveshjes me Pfizer, i cili ishte në formën e draftit, sot ndërkohë është e njëjta përmbajtje që vjen në formën e nënshkruar nga palët përkatëse.

Zonja Tomini, fjala është për ju.

**Eugena Tomini** – Mirëdita të gjithëve!

Zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për ftesën!

Ashtu siç edhe ju e përmendët, sot jemi për t'iu paraqitur faktikisht aktin normativ, i cili miraton disa ndryshime në lidhje me marrëveshjen Pfizer. Ndryshimet tashmë bazohen mbi aktin normativ, ashtu siç edhe ju e përmendët, por teksti i sjellë te ju sjell ndryshime, në bazë të kontratës, vetëm në ndryshim të sasisë totale të marrëveshjes rishtazi me firmën prodhuese Pfizer. Prandaj, risia e vetme ose çka unë kam për t'ju shpjeguar është vetëm fakti i ndryshimit të dozave dhe sasisë që kompania Pfizer sjell në bazë të marrëveshjes me qeverinë shqiptare dhe përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë, Institutin e Shëndetit Publik dhe me ministrin e Shtetit për Rindërtimin që edhe ju përmendët. Kjo është e vetmja risi, pra sasia dhe numri i dozave për vaksinën Pfizer.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Tomini!

Në fakt, po, është e njëjta përmbajtje siç kemi diskutuar në mbledhjen e komisionit kur bëmë edhe shqyrtimin e aktit normativ të kaluar. Kështu që sot ne do të jemi vetëm për shqyrtimin e aktit normativ, i cili, në fakt, të njëjtin draft-tekst të marrëveshjes e ka kthyer në një akt të detyrueshëm për palët; të nënshkruar.

Fjalën e ka zoti Toni Gogu në cilësinë e relatorit.

**Toni Gogu** – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Akti normativ nr. 30, që kemi përpara, është sjellë në zbatim edhe të nenit 101 të Kushtetutës. Rrethanat specifike të nevojës dhe të urgjencës qëndrojnë ende në fuqi, për shkak se jemi në kushtet e pandemisë dhe vaksina është e vetmja mënyrë për ta luftuar atë.

Siç u tha edhe nga përfaqësuesit e ministrisë, po edhe nga kryetarja u cilësua, teksti i projekt marrëveshjes që ne miratuam përpara disa javësh në këtë komision dhe në Kuvend tashmë është i nënshkruar. Kështu që ky është ratifikimi përfundimtar që i bëhet kësaj marrëveshjeje. Siç e thashë, është në zbatim të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit me të gjitha elementet përkatëse, ndaj ju ftoj ta miratojmë atë.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Shumë faleminderit, zoti Gogu!

Atëherë, duke qenë se diskutimet janë të njëjta me mbledhjen që kemi kryer javët e mëparshme, jeni dakord, kolegë, të kalojmë në votim?

Dakord.

Kush është dakord me aktin normativ nr. 30, datë 27.9.2021?

Të gjithë shprehen dakord.

Atëherë, miratohet.

Të bëhet gati relacioni përkatës dhe t'i kalojë seancës plenare për shqyrtim.

Unë e mbyll këtu mbledhjen e komisionit për sa kohë kemi ezauruar të gjitha pikat e rendit të ditës.

Ju falënderoj! Për mbledhjen tjetër do të njoftoheni, ndërkohë faleminderit edhe ju, zonja Tomini, për prezencën në komision dhe punë të mbarë!

Mirupafshim!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, kolegë, më njoftojnë nga sekretaria t'ju bëj një rikujtesë që sot në orën 14:00 është mbledhja e përbashkët e Këshillit të Legjislacionit dhe Komisionit të Ligjeve në kuadër të procedurës parlamentare për shqyrtimin e ndryshimeve kushtetuese. Mbledhja do të organizohet në sallën e Byrosë së Kuvendit. Kështu që merrni masa për të qenë të pranishëm.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**